

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 28, datë 28.10.2021


Për miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “g” dhe nenit 53, pika 6, shkronja “ç” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “p” dhe të nenit 8, pika 2, shkronja “f” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 24, datë 31.10.2018, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, bëhen shtesat si vijon:

1. Në aneksin 1 “Struktura organizative” bashkëlidhur vendimit, pas pozicionit të punës “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm” shtohet pozicioni i punës “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm”, me edukimin “fakulteti ekonomik/juridik dhe MPA/MBA të preferueshëm”.
2. Në aneksin 2 “Organika”, bashkëlidhur vendimit bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:
 - a) shtohet pozicioni i punës “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm” në varësi të drejtpërdrejtë të pozicionit të punës “Drejtor i Përgjithshëm”;
 - b) përshkrimi i punës për pozicionin “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm”, zëvendësohet me tekstin e aneksit bashkëngjitur këtij vendimi.



KËSHILLI DREJTUES

3. Numri i punëmarrësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave bëhet 30 gjithsej.
4. Efektet financiare të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar